

K E R K E S Ë

PËR SHPALLJEN TË ZHDUKUR TË ILIRIAN MUSTAFAJIT GJYKATËS SË RRETHIT TË VLORËS

Kërkuese: Shpresa Mustafajit e bija e Remziut, datëlindja 1966, lindur dhe banuese në Babicë të rrethit Vlorë, e martuar dhe me një fëmijë.

Objekti: Shpalljen si të zhdukur të bashkëshortit Ilirian Mustafaj, në bazë të neneve 15 e vijues të Kodit Civil dhe 375 e vijues të Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë.

Parashtoj se siç rezulton dhe nga certifikata e martesës datë 2.3.1989 figuroj e martuar me Ilirian Mustafain, martesë kjo e lidhur më datën 21 korrik 1989. Nga martesa kemi një fëmijë të përbashkët Zenel Mustafajin i datëlindjes 1989, i cili aktualisht mbahet nga unë për rritje dhe edukim.

Në muajin qershor 1991 rreth datës 3, bashkëshorti im është larguar nga pylli i Poros me pesëmbëdhjetë persona të tjerë në drejtim të Italisë.

Ndërsa shokët e tij kanë arritur në Itali, për atë nuk dihet asgjë lidhur me fatin e tij, nëse mbërriti apo jo. Që nga ajo ditë unë nuk kam asnjë lajm për të, si dhe nga familjarët e tij.

Nisur nga kjo kërkoj që konform ligjit, të shpallet i zhdukur dhe më vonë të ndjek dhe procedurat e tjera për shpalljen e tij të vdekur.

Kërkoj nga gjykata që të respektohen procedurat e parashikuara nga ligji.

Bashkëngjitur ju paraqes dhe dokumentet përkatëse.

KËRKUESJA
Shpresa Mustafaj